



ILLYRIAN GUARD SH.A.

Nr. 2324/1 / Prot.

Tiranë, më 06.12 .2023

Lënda: Kthim përgjigje

**DREJTORISË RAJONALE
TË OSSH TIRANË**

(Rruga "Reshit Petrela", Përballë Dispanserisë, Tiranë)

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 4314/1, datë 05.12.2023, "Lidhur me shërbimin e ruajtjes, shoqërimit dhe transportimit të vlerave monetare për Njësitë e Koordinimit Tiranë FSHU SH.A ", ju bëjmë me dije se:

Megjithëse Shoqëria "Illyrian Guard" Sh.A ka realizuar liçencimin për shërbimin në nënkategorinë 1.3.B "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit", ende ky shërbim nuk është në efikasitet të plotë.

Referuar më sipër, ju bëjmë me dije se Shoqëria "Illyrian Guard" Sh.A, nuk mund të ofrojë shërbimin e nënkategorisë 1.3.B deri në momentin që pritet të plotësohen kushtet e sipërpërmendura.

Sa më sipër, ne ju rekomandojmë, që në rast se brenda vitit 2024, shoqëria "Illyrian Guard" SH.A do të marrë përsipër ofrimin e këtij shërbimi, bazuar në VKM-në nr.177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë «Illyrian Guard» SH.A, dhe për përcaktimin e Autoritetit Publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie", të vendoset klauzola që marrëveshja kuadër dhe çdo kontratë e lidhur në bazë të saj që do të jetë në vazhdim, do të konsiderohet e zgjidhur nga hyrja në fuqi e kontratës me "Illyrian Guard" SH.A.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ADMINISTRATORI

ANDUEL XHINDI

